

JORGJI GJINARI

DIFTONGJET* UA/UE, IE DHE YE NË TË FOLMET E GJUHËS SHQIPE

Në këtë kumtesë do të bëjmë objekt trajtimi tri nga diftongjet e shqipes, vetëm ata që kanë dalë nga zbërthimi i një zanoreje, e pikërisht: *ua/ue*-në, që ka dalë nga *o*-ja dhe *ie*-në e *ye*-në që kanë dalë nga *e*-ja. Në radhë të parë do të flasim mbi gjendjen e sotme të këtyre diftongjeve nëpër të folmet e shqipes, pastaj do të përpiqemi të shpjegojmë shkaqet fonetike të zhvillimeve jo të njëjta që muarën ato nëpër të folme të ndryshme, për afërisht që nga koha kur *uo*-ja u degëzua në *ua/ue* e gjer më sot. Do të lëmë jashtë vështrimin tonë në këtë kumtesë fazat shumë të hershme të zhvillimit të këtyre diftongjeve, lindjen e tyre prej një zanoreje, për të cilën ka shkruar G. Majeri¹, gjithashtu edhe fazat e para të *ua/ue*-së, që nga dalja e tyre prej *o*-së e deri tek *uo*-ja, me të cilat është marrë në një studim të posaçëm N. Jokli².

Problemin e shkaqeve fonetike të zhvillimeve të ndryshme të diftongjeve të shqipes në fazat e vona e kanë prekur edhe më parë studjues të gjuhës sonë, si Gj. Pekmezi³, E. Çabej⁴ dhe A. Dodi⁵: për ndonjë çështje të pjesshme ka çfaqur mendime edhe K. Cipo⁶. Edhe ne jemi ndalur dhe kemi folur shkurt për këtë problem në diskutimin tonë⁷ që bëmë mbi kumtesën e A. Dodit, të mbajtur në Konferencën e parë të studimeve albanologjike.

Po e lëmë mënjanë diftongun *je/je/* të foljeve të tipit *vjel*, *naxjerr*, *pjek* si dhe të disa fjalëve të tjera, si: *vjen* (lat. *venio*), *mjek* (lat. *medicus*), *Shtjefën* (lat. *Stephanus*) etj., po e veçojmë nga *ie*-ja e fjalëve *diell*, *miell*, *ziej*, etj., sepse në rastet e para *ie*-ja ka dalë nga një *ē*⁸ dhe, me sa duket, më herët se *ie*-ja tek *diell* etj. Dallimin që bëmë midis *ie*-së së fjalëve *vjel* etj. dhe *ie*-së së fjalëve *diell* etj. e mbështet edhe fakti që diftongu i

*) Veç rasteve ku flitet për gjendjen e sotme, në të tjerat termin diftong e kemi përdorur me kuptim të padiferencuar.

1) G. Meyer, *Albanesische Grammatik*, Leipzig, 1888, f. 4, 5.

2) N. Jokl, *Zur Geschichte des Alb. Diphthongs — ua, — ue*, në «*Indogerm. Forschungen*», 49 (1931), f. 274-300, 50 (1932), f. 33-58.

3) Gj. Pekmezi, «*Grammatik der Albanesischen Sprache*», Wien, 1908.

4) E. Çabej, «*Diftongje e grupe zanoresh të shqipes*», në «*Buletin për shk. shoq.*», 1958, f. 71-89 dhe «*Fonetika historike e gjuhës shqipe*» (dispensë), Tiranë, bot. I, 1958, bot. II, 1960.

5) A. Dodi, «*Diftongjet e shqipes së sotme nga pikëpamja fonetike dhe fonologjike*», në «*Konferenca I e studimeve albanologjike 15-21 nëntor 1962*», Tiranë, 1965, f. 195-204.

6) K. Cipo, «*Gramatika shqipe*», Tiranë, 1949.

7) Botuar në «*Konferenca I e studimeve albanologjike*» (15-21 nëntor 1962), Tiranë, 1965, f. 372-374.

8) G. Meyer, *vep. cit.*, f. 4.

parë mbeti i ngurosur si diftong ngjitës i shkurtër pothuajse kudo dhe në përgjithësi zhvillimi i tij nuk u bë krahas me diftongjet e tjera *ua/ue, ie, ye*.

Ka edhe raste si: *bie, shtie, shpie*, në të cilat *ie*-ja vende-vende shqiptohet si tog zanoresh e në disa të folme del e monoftonguar në *i*, por në këto forma të dëftores e të lidhores së tashme *ie*-ja është në rrokje fundore të hapur, ndryshe nga format: *bjer(ë)!, shtjer(ë)!, shpier(ë)!* dhe nga *mbjell, vjen* etj. ku ajo është ndodhur gjithmonë në rrokje të mbyllur të shkurtër. Kur *bie, shtie, shpie* kanë dalë në këtë përbërje fonetike që shohim sot, *ie*-ja është zbërthyer në togje zanoresh, sepse është zgjatur (krahaso sot trajtat e dëftores së tashme veta I nj. të të njëjtit zgjedhim: *hā, pī* etj.).

Për të kaluar në problemin e kumesës sonë, nuk po ndalemi më gjatë e të merremi me çështje të tjera të *ie*-së që vjen nga një *ë*, sepse kjo mund të bëhet objekt i një studimi të veçantë.

Cila është gjendja e sotme e diftongjeve *ua/ue, ie, ye* nëpër të folmet e shqipes? Ku shqiptohen si diftongje, ku si togje zanoresh⁹ dhe ku janë të monoftonguara?

Në përgjithësi mund të thuhet se në një të folme pak a shumë të tri diftongjet kanë ecur krahas njëri-tjetrit gjatë zhvillimit të tyre¹⁰.

Në dialektin jugor:

Në të folmet e toskërishtes jugore, ku përfshihen ato të Çamërisë, të Bregdetit, të Kurveleshit, të Gjirokastrës, të Lunxherisë dhe të Zagorisë, si dhe në disa të folme të toskërishtes veriore, si në ato të Përmetit e të Dangëllisë, të Shqërisë, deridiku edhe në ato të Oparit e të Gorës, ka togje zanoresh në të gjitha pozitat: *duar, bualli, ftua, diell, dielli, u përzie, dyer, fyelli, u thye*. (Atje ku mungon *y*-ja në vend të *ye*-së ka *ie*).

Në shumë të folme të toskërishtes veriore, e pikërisht në të folmet e Myzeqesë, të Mallakastrës, të Beratit, të Skraparit, të Mokrës, të Progradcit, të Korçës, të pjesës veriore të Kolonjës si edhe në të folmen e Vlorës, bashkë me ato të fshatrave që ndodhen rreth Selenicës e pranë Urës së Mifolit, ka togje zanoresh vetëm në rrokje fundore të hapur, kurse në pozita të tjera ka diftongje ngjitëse: *ftua, u përzie, u thye dhe duar*¹¹, *shualli, diell, dielli, fyell, fyelli*. Në një numër të vogël të folmesh të këtij nëndialekti të toskërishtes, si në të folmen e Devollit, të Skraparit jugor (ajo që shtrihet në të majtë të Osumit), të Dëshnicës dhe të Tepelenës (pjesa toske edhe pjesa labe), ka diftongje ngjitëse në të gjitha pozitat: *duar, shualli, ftua, diell, dielli, shtie, fyell, fyelli, u thye*.

Në dialektin verior:

Të folmet e brendshme malore të skajit verior kanë togje zanoresh në të gjitha pozitat (janë të rralla rastet me monoftongim), kështu

9) Termin *tog zanoresh* e përdorim për dy zanore që janë pranë njëra-tjetrës dhe që shqiptohen duke formuar secila rrokje më vehte, ndryshe nga diftongu, elementët e të cilit shqiptohen së bashku në një rrokje.

10) Për gjendjen e sotme të diftongjeve në të folmet e shqipes jam mbështetur kryesisht në materialet e dhëna prej punimeve dialektologjike të botuara që nga v. 1955 këtej në «Buletin për Shkencaat Shoqërore», në «Buletin të USHT-së seria Shk. Shoq.» dhe në «Studime filologjike», si dhe në materialet e pabotuara të Kartotekës së dialektologjisë të Institutit të historisë e të gjuhësisë.

11) Në Myzeqe, në Berat, në Mallakastër dhe në Vlorë elementi i dytë i diftongut *ua*, që ndodhet në trup të fjalës, shqiptorhet i labializuar (a^o): *dua^or, bua^olli* etj.

ka *ie* (diell, ka zie), *ye* (lyej, ka lye) në të gjitha të folmet dhe *ue* në çfarëdo pozite në Dukagjin, në Tropojë e në Kukës (*duer, e rrxue*), kurse në Malësinë e Madhe ka më shpesh *ua* në rrokje fundore të hapur: *kam shkua* (rrallë ka edhe *uo* ose *uë*) dhe *uo* në pozita të tjera: *duol, mzuor* (rrallë edhe *ue*).

Në të folmet që shtrihen ndërmjet Drinit dhe Matit *ue*-në përgjithësisht e gjejmë tog zanoresh në rrokje fundore të hapur dhe të monoftonguar në pozita të tjera: *due, me knue, ka zapue* dhe *dul, pagjuj «paguaj», bulli, e garkume* (rrallë ka raste që tregojnë edhe të kundërtën). Afërsisht kjo gjendje konstatohet edhe në të folmet që shtrihen në vazhdim të tyre nga ana e lindjes, prej Dibre e Gostivari deri në Shkup e në Kumanovë.

Në të folmet e gegërishtes jugore, dmth në ato që ndodhen ndërmjet Matit e Shkumbinit, në çdo pozitë diftongjet janë monoftonguar: *m ka bështu, ka je tu shku? dul, ruji, me zi, i përzim, e përzime, kam thy, thyj, thyva*. Po kështu janë monoftonguar diftongjet edhe në të folmet e disa zonave të ulta veriperëndimore e verilindore, si në ato të Shkodrës, të Gjakovës, të Pejës dhe të rrethinave të tyre.

Në brezin e të folmeve kalimtare:

Me përjashtim të të folmeve të Vërçës dhe të Rajcës, ku ka tog zanoresh *ua* në të gjitha pozitat (me këto afrohet edhe Polisi), të tjera të folme kalimtare, si ato të Shpatit, të Sulovës, të Dumresë, të Darsisë së Peqinit, të fushës së Lushnjës dhe të Bregdetit të Poshtëm të Kavajës, vetëm në rrokje fundore të hapur kanë tog zanoresh *ua*, kurse në pozita të tjera kanë *u*, ashtu si në gegërishten jugore: *grua, mua, thua, kam punur, ke lërrur, dul, dur, shulli* etj. Edhe *ie*-ja e *ye*-ja afërsisht po këtë rrugë kanë ndjekur, vetëm se *ie*-ja gjendet edhe e pamonoftonguar në shumë të folme të kësaj zone.

Në ngulimet e shqiptarëve jashtë atdheut:

Në të folmet e arbëreshëve të Italisë (me përjashtim të Montecilones, ku diftongjet janë monoftonguar) dhe në të folmet e arbëreshëve të Greqisë¹², ashtu si në toskërishten jugore, gjejmë togje zanoresh në të gjitha pozitat: *grua, gruaaja, shkruajtinë*. Në këto të folme arkaike në rrokje të mbyllura dhe të hapura në trup të fjalës është ruajtur edhe *uo*-ja, e cila sipas M. Lambertcit¹³, tek arbëreshët e Italisë shqiptohet edhe si diftong ngjitës: *duortë, muormë, buoll, ngalkuom* (Greqi), *duomi* (duam), *kish paguor, kloft bekuor* (Itali).

Edhe në të folmen e shqiptarëve të Dalmacisë ka togje zanoresh në çdo pozitë. Këtu gjendet zakonisht *ua* në rrokje fundore të hapur, kurse në pozita të tjera sipas K. Taliavinit¹⁴ ka *uo*, ndërsa sipas G. Vajgandit¹⁵ ka *ua*.

Në të folmen e shqiptarëve të Ukrainës¹⁶ diftongjet janë monoftonguar: *đu* (dua), *muj* (muaj), *shëmturë* (shëmtuarë), *dill* (diell), *mill* (miell), *bi* (bie), *pys* (pyes), *dyr* (dyer), *kry* (krye).

12) Nuk janë shënuar si diftongje te: C.H. Reinholdi «Noctes Pelasgicae», Athen, 1855; G. Weigand, «Das albanische in Attika», në Balkanarchiv, 2(1926); A.P. Furiki, «I en Attiki Elinovalvaniki dialektos», në «Athina», 44(1932), 45(1933).

13) M. Lambert, Albanesische Mundarten in Italien.

14) C. Tagliavini, L'albanese di Dalmazia, Firenze, 1937.

15) G. Weigand, «Der gegische Dialekt von Borgo Erizzo bei Zare in Dalmatien», në «JbIRS XVII-XVIII» (1911), f. 177-239.

16) S. Islami, Materiali gjuhësor nga kolonitë shqiptare të Ukrainës, në «Bulet për Shk.Shqoq.», 2,1955, f. 163-180 dhe N.Z. Kotova, Materiali po albanskoj dialektologii (albanskije govori Ukraini), në Uçjon. Zap. Inst. Slav. XIII, 1956.

Në të folmen e Mandricës në Bullgari nuk ka vepruar fenomeni i monoftongimit, por nuk dimë në se shqiptohen si diftongje apo si togje zanoresh, sepse autorët¹⁷ e një studimi që ekziston mbi këtë të folme nuk japin shpjegime. Atje ka *ua*, por edhe *uo*, sidomos në trup të fjalës: *grua* (edhe: *gruva*, *gruo*, *gruvë*), *dualnë*, *kërkuanë*, *punuoka*, *martuoka*, dhe *buoll*, *duor*; *ye*: *kërcyeka*, *u ksyë* (u kthye): për *ie*-në, duke sjellë autorët e atij studimi vetëm një shembull, shenojmë se ka kaluar në *je*: *djella* (dielli).

Ne dhamë këtu në vija të përgjithshme gjendjen e sotme mbizotëruese të diftongjeve sipas pozitive në fjalë dhe ju shmangëm variacioneve e lëkundjeve që vërehen në disa të folme, sidomos në disa nga ato të gegërishtes qëndrore e veriore.

Shihet se diku ka togje zanoresh në të gjitha pozitat e diku vetëm në rrokje fundore të hapur, në një zonë ka diftongje ngjitëse në të gjitha pozitat e në një tjetër vetëm në trup të fjalës, ndërsa në disa të folme diftongjet janë monoftonguar në çdo pozitë e në disa të tjera vetëm në trup të fjalës.

Toskërishtja paraqitet më e njësuar se gegërishtja, ku në disa të folme jetojnë krahas njëri-tjetrit variantet *uo*, *ua* e *ue* dhe ku gjithashtu vërehet një dallim i madh midis të folmeve të saj: në disa ka togje zanoresh, kurse në disa të tjera diftongjet janë monoftonguar.

Përse është kjo gjendje sot? Siç do të shpjegojmë më tutje, zhvillimet e ndryshme që kanë pësuar këto diftongje nëpër të folmet e shqipës kanë qenë të lidhura me gjatësinë që kanë ruajtur ose që kanë fituar ato, me pozitën në fjalë dhe me karakterin e rrokjes ku kanë bërë pjesë.

Për mungesë të dhënash, që të ishin të dokumentuara në shkrimet e vjetra, ose që të gjenden në gjuhën e sotme të gjallë, është vështirë të provohet në se kanë kaluar këto diftongje gjatë zhvillimit të tyre nëpër shkallën e diftongjeve të vërtetë ose të ekuilibruar, siç quhen diftongjet me komponentë barabar të theksuar. Prandaj hëpërhë po e lëmë mënjani mendimin që kemi shprehur në një vend tjetër më parë¹⁸ dhe po shpjegojmë vetëm kushtet e ndryshme fonetike që në disa të folme shkaktuan zberthimin e diftongjeve në togje zanoresh, në disa monoftongimin e tyre dhe në disa të tjera ruajtjen si diftongje.

Shqiptimin si togje zanoresh të diftongjeve i pari e ka konstatuar O. Dozoni¹⁹ në zonën e Përmetit, por, duke mos e njohur atëherë prejardhjen e tyre nga zberthimi i një zanoreje, arrin në përfundimin se shqipja nuk duhet të ketë pasur diftongje të mirëfilltë dhe *ua*-në e quan si një bashkim dy zanoresh që formojnë dy rrokje.

Më vonë H. Pedersen²⁰, duke bërë një përgjithësim, thotë se diftongjet shqiptohen togje zanoresh në shqipen jugore (mund ta ketë bërë këtë përgjithësim duke u mbështetur vetëm në toskërishten jugore). Nuk jep shpjegime për këtë dukuri në shqipe, por vetëm sjell fakte edhe nga gjuhë të tjera ku konstatohet po e njëjta gjë.

K. Cipo në «Gramatikën shqipe» (1949), f. 12, pasi jep mendimin se sot në shqipe (me sa duket, në shqipen e përbashkët letrare) tek fjalët *diell*, *ruaj*, nuk ka diftong, sepse shqiptohen të theksuara zanoret *i* dhe

17) M. Domi — Dh.S. Shuteriqi, *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, në «Stud. filol.» 2, 1965, f. 103-118.

18) J. Gjinari, *art. cit.* f. 372-374.

19) O. Dozon, «Manuel de la langue chkipe ou albanaise», Paris, 1879.

20) Sipas një shenimi të E. Çabejt në artikullin e cituar *Diftongje e grupe zanoresh të shqipes*, f. 77.

u, thotë më poshtë: «*nuk formon diftong edhe kombinimi i dy zanoreve kur vjen pas një bashkëtingëlloreje r a l p.sh. triumf, prials, kriesë, klient, triak, krioj, tryezë etj.*». A. Dodi²¹, duke e zhvilluar këtë mendim, jep një shpjegim, sipas të cilit: «*...sonantet, qoftë kur janë përpara diftongut, veçanërisht r, l, tentojnë të tërheqin theksin drejt vehtes, duke arritur nganjëherë edhe në ekulibrimin e elementeve*»... dhe jep shembuj: *tryezë, tryel, klient luan, luadh*, me tog zanoresh dhe *duar, duan* me diftong. Faktet me tog zanoresh, si *tryezë, tryel, klient* etj. janë reale dhe i gjejmë në gjuhën letrare e në të folmet popullore, por mendojmë se shkaku nuk duhet të jetë ai që është dhënë, sepse si do të shpjegoheshin atëherë faktet e shumta me diftong: *ruanj* ose *ruaj, kruanj, luanj, lyenj, përmiër, rjep*. (=rriep) etj.? Shkaqet, që në këto raste diftongjet shqiptohen si togje zanoresh, duhet të jenë të tjera dhe të ndryshme. Për disa shkaku është fonetik, togjet e zanoreve në ato raste nuk vijnë nga zberthimi i një zanoreje, por janë kombinacione si rezultat i ndryshimeve fonetike që ka pësuar fjala (*tryel* krahaso *turjel, luadh* krahaso *livadh, livad*). Për disa duhet marrë parasysh shqiptimi në gjuhën nga janë marrë hua (*klient, triumf*, etj.) dhe për disa të tjera duhet parë morfologjia e tyre (*krijesë* <kri+esë, *kri(j)oj* <kri+o—j, *luan*, ose *lua* vjen sipas E. Çabejt²² nga një *luo* — *loni* me prapashtesë zmadhimi -â (<-an) si tek *patâ* — *patâni*).

A. Dodi²³ në përgjithësi shkaku e zberthimit të diftongeve në togje zanoresh e gjen tek shpërngulja e theksit në një rrokje më përpara dhe në ballë të këtij procesi mendon se ka qenë gegërishtja, ku siç thotë ai, «*këtë dukuri e vemë re edhe në fjalë të tjera të tipit ai*». Por zberthimi i diftongjeve në togje zanoresh nuk ka ndodhur vetëm në gegërishte, ai është kryer dhe në shumë të folme të toskërishtes, prandaj vendosja e theksit në elementin e parë nuk duhet të ketë qenë si shkak, por si rezultat i procesit të zberthimit të diftongjeve për shkak të gjatësisë së tyre dhe shpërngulja e theksit u bë në përputhje me veçoritë e përgjithshme të mbarë shqipes, sipas së cilës fjalët që kanë më shumë se dy rrokje duhet të jenë paroksitone.

Në mendojmë se diftongjet u zberthyen në ato të folme ku nuk u shkurtuan për nga gjatësia, atje ku, siç ka mundësi më tepër, vazhduan të shqiptoheshin të gjata. Them i kështu, sepse procesi i zberthimit të diftongjeve ka ndodhur kryesisht në gegërishten dhe në toskërishten jugore, ku janë ruajtur mirë deri sot zanoret e gjata, qoftë primaret, qoftë edhe ato sekondaret të formuara për shkak të pozitës në fjalë ose për shkak të ndryshimeve fonetike që kanë pësuar fjalët.

Në ato të folme ku diftongjet janë monoftonguar (në disa të folme vetëm në trup të fjalës, kurse në disa të tjera në të gjitha pozitë) ka mbetur elementi i parë, i cili, për shkak se bart peshën e theksimit, ka reduktuar dalëngadalë elementin e dytë, që ka qenë i lirë nga theksimi, gjersa e ka tretur krejt. Ky proces mund të ndodhë në një diftong zbrictës ose në një tog zanoresh. Gj. Pekmezi²⁴, kur flet për diftongun *ie*, duke përgjithësuar për tërë dialektin gegë, thotë: «*në gegërishte haset shpesh diftongu i gjatë ie (e shënon ie) vetëm se ai, veçanërisht në rrokje të mbyllur, monoftongohet...*»; më poshtë thotë se *î, ŷ, û*, të përfutuara

21) A. Dodi, *art. cit.*, f. 198, 189.

22) E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, në «Stud. fil.» 2, 1964, f. 32.

23) A. Dodi, *art. cit.* f., 198, 202.

24) Gj. Pekmezi, *vep. cit.*, f. 7.

nga monoftongimi, shqiptohen me një ton zbritës e më të gjata se *i*, *y*, *u*. Megjithëse Gj. Pekmezi në Gramatikën e vet nuk bën dallimin midis diftongjeve dhe togjeve të zanoreve, nga ato që përmendëm më sipër, duket se monoftongimi, sipas tij, ka ndodhur në një diftong zbritës. Ne themi se kanë më tepër të drejtë E. Çabej²⁵ dhe A. Dodi²⁶, të cilët mendojnë se procesi i monoftongimit ka ndodhur në togje zanore. Po ne do të shtonim që, meqenëse ky proces ka ndodhur në një tog zanore, atëherë është më e drejtë të thuhet se në këtë rast kemi të bëjmë me një kontraksion zanore.

Gj. Pekmezi²⁷ monoftongimin e shpjegon me ndikimin e elementit muzikor, që, sipas tij, shfaqet me forcë në shqiptimin e rrokjeve të gjata, sidomos kur ato janë të mbyllura. Këtu ka një konstatim me vlerë, që monoftongimi ndodh në rrokje të gjata të mbyllura, por shkaku i kësaj procesi nuk mund të shpjegohet me ndikimin e elementit muzikor, qoftë edhe sikur të jetë e vërtetë shfaqja e tij në gegërishte.

Të dhënat e sotme dialektore tregojnë se në një zonë të madhe të gegërishtes, në atë që ndodhet midis Drinit e Matit, dhe në të folmet kallimtare, diftongjet dalin rregullisht të monoftonguar vetëm në trup të fjalës (në rrokje të mbyllura ose të hapura). Ky fakt të çon tek mendimi se monoftongimi për herë të parë është kryer në trup të fjalës. Kushtet fonetike që e kanë shkaktuar atë nuk kanë qenë vetëm gjatësia e diftongjeve, sepse ky kusht ka ekzistuar edhe për të folmet skajore të gegërishtes e të toskërishtes, ku diftongjet për shkak të gjatësisë janë zbërthyer e kanë mbetur togje zanore. Ne mendojmë se me këtë rast, së bashku me gjatësinë, në rrokjet që ndodhen në trup të fjalës ka ndikuar edhe intensiteti relativisht më i madh që ka theksi dinamik i fjalës në përgjithësi në gegërishte e sidomos në gegërishten jugore, ku konstatohet monoftongimi në të gjitha pozitat dhe ku gjithashtu kanë ndodhur reduktime të tjera e të shumta, të cilat herë-herë kanë çuar deri në zhdukje tingujsh ose rrokjesh.

Diftongjet që vazhdojnë të jetojnë akoma vetëm në toskërishten veriore shqiptohen sot të shkurtëra dhe ngjithëse: *buall-i*, *fyell-i*, *diell-i* (në disa të folme, siç kemi thënë, ka diftongje edhe në rrokje fundore të hapur: *thua*, *u thyë*, *bie*).

Gj. Pekmezi²⁸ ka konstatuar në toskërishten lindore kthimin e diftongut *ie* në *je* [*ië*] dhe thotë se kjo ndodhi, meqenëse toskërishtja shkoi në rrugën e shkurtimit të diftongut. Po të jetë fjala këtu vetëm për diftongun *ie* të fjalëve *mbjell*, *vjel* etj. të ardhur nga një *ë*, kjo, siç e kemi thënë, ka ndodhur në të gjitha të folmet e shqipes, kurse në toskërishten veriore shkurtimi ka përfshirë edhe tri diftongjet që po shqyrtojmë. Në toskërishten veriore, siç dihet, nuk janë ruajtur zanoret e gjata dhe për pasojë as diftongjet e gjata, kështu, duke filluar për herë të parë në rrokje të mbyllura, diftongjet u shqiptuan të shkurtëra dhe u ruajtën ashtu si diftongu i vjetër *je* [*ië*] i fjalëve: *vjel*, *pjek*, *Pjetër*, *vjet*, *vjen* etj. Pasi ndodhi në rrokje të mbyllura, ky proces përfshiu edhe diftongjet në rrokje të hapura në trup të fjalës, gjë që duhet të jetë bërë për analogji ose për shkak se edhe më parë diftongjet nuk shqiptoheshin të gjata në këtë pozitë, kurse në rrokje fundore të hapura

25) E. Çabej, «Diftongje e grupe zanore të shqipes», f. 71.

26) A. Dodi, *art. cit.*, f. 202, 203.

27) Gj. Pekmezi, *vep. cit.*, f. 7, 16.

28) Po ai, *po aty*, f. 16.

në shumicën e të folmeve, përkundrazi, ato u zbërthyen, sepse në një pozitë të këtillë nuk mund të shkurttoheshin.

Nuk jemi në gjendje tashti të shpjegojmë se përse, por po mjaftohemi të themi se bëjnë përjashtim në këtë rast të folmet e Devollit, të Skraparit jugor, të Dëshnicës dhe të Tepelenës, që kanë diftongje në fund të fjalës në rrokje të hapur.

Gjithashtu duhet thënë se në ato të folme të toskërishtes veriore, ku në rrokje fundore të hapur rregullisht ka togje zanoresh, tek emrat që mbarojnë në të pashquarën me *o* të patheksuar, kur shquhen, dalin me diftong *ua*: *Spirua*, *Taqua*, *Malua*, *mapua*, *karrua* etj. Shpjegimin e formimit të diftongut *ua* në rastet si këto na e jep morfologjia e këtyre emrave: këtu diftongu ka lindur nga bashkimi i *o*-së së shkurtër e të patheksuar të temës me nyjen e prapme shquese *a* (khas. formimin e trajtës së shquar të këtyre emrave në të folme të tjera: *Spiro-Spiroja* ose *Spirja* etj.). Duke u bashkuar *o*-ja dhe *a*-ja të patheksuara (*Taqo+a*), kanë formuar një diftong jo të gjatë (*oa* (**Taqoa*)), i cili u kthye pastaj në *ua* dhe u bashkërendua me diftongun *ua* që ekzistonte në fjalë të tjera, ku ka ardhur nga zberthimi i *o*-së.

Për kronologjinë e zhvillimeve të ndryshme që kanë pësuar diftongjet nëpër të folmet e shqipes, përveç monoftingimit, i cili sipas E. Çabejt²⁹ dokumentohet për herë të parë më 1710, është vështirë të thuhet ndonjë fjalë, sepse dokumentat e shkruar në të dy dialektet nuk kanë shënuar me anë të grafisë gjatësinë e diftongut, hapjen e tyre në togje zanoresh dhe kalimin në diftongje të shkurtëra ngjitëse.

Shihet se diftongjet *ua/ue, ie, ye*, duke ecur të gjithë krahas njëritjetrit brenda një të folmeje, gjatë zhvillimit të tyre kanë marrë rrugë të ndryshme në treva dialektore të ndryshme të shqipes. Pa lënë mënjane edhe faktorin social, që ka ndihmuar deri në një farë mase në përhapjen gjeografike të rezultateve të proceseve që kanë ndodhur, duket qartë se zhvillimi i diftongjeve ka qenë i kushtëzuar nga gjatësia e tyre, nga intensiteti i theksit dhe nga pozita që kanë pasur në fjalë, dmth nga karakteri dhe vendi i rrokjeve ku janë ndodhur, pra ka qenë një ndryshim fonetik pozicional që është bërë sipas rregullave të caktuara në mënyrë jo të njëjtë në treva dialektore të ndryshme. Këto kushte të ndryshme fonetike që u krijuan nëpër të folmet e shqipes shkaktoan për diftongjet dallimet që vërehen sot: zberthimin e tyre e mbetjen si togje zanoresh në disa të folme, monoftingimin ose shkrirjen e dy zanorevet në një të vetme në disa të folme të tjera dhe formimin e diftongjeve të shkurtëra ngjitëse në të folme të tjera.

Diftongimi nuk vepron sot. Që kjo dukuri nuk është sot e gjallë, e tregojnë në mënyrë bindëse këto fakte: shrirja e diftongjeve me anë të analogjisë edhe në ato pozita ku kushtet fonetike nuk e përlligjin: *mbuallëm, mbuallët, lyeva* etj. dhe njësimi me *o* i emrave të tipit *lakruar* në trajtën e shquar dhe të pashquar: *lakror-i, qershor-i, krahror-i, etj.* (bile ka filluar të duket kjo edhe në emrat e tipit *truall, shuall: troll-i, sholl-i*). Njësimi me *o* tek *lakror-i* etj. po bëhet, sepse nuk vepron diftongimi tek emrat e shumtë që formohen sot me prapashtesën *-or* (*blegtor, epror, rreshtor, etj.*) si edhe tek fjalët e huazuara që mbarojnë me *-or, -oll, -on* (*motor, tornitor, futboll, ballkon etj.*).

29) E. Çabej, *Diftongje e grupe zanoresh të shqipes*, f. 77.

Për shkak të ndikimit të të folmeve popullore mbi njëra-tjetrën sot vërehet si tendencë e përgjithshme shtrirja e togjeve të zanoreve në dialektin jugor dhe shtrirja e monoftongimit në dialektin verior. Njëkohësisht mbi të folmet në këtë drejtim sot ushtron një ndikim të madh edhe gjuha e përbashkët shqipe, sidomos gjuha letrare, me anë të shkollës, të radios e të shtypit, që kanë marrë një përhapje të gjërë e masive në vendin tonë. Nën ndikimin e gjuhës letrare po fillojnë të përhapen kudo togjet e zanoreve. Këto tregojnë se për ndryshimet që pësojnë diftongjet sot luan një rol të madh faktori social.

R é s u m é

LES DIPHTONGUES *ua/ue*, *ie* ET *ye* DES PARLERS DE L'ALBANAIS

Il s'agit de trois diphtongues de l'albanais, les seules qui représentent la décomposition d'une voyelle, et précisément: ua/ue, dérivant de o, et ie, ye dérivant de e. Tout d'abord il y est question sur l'état actuel de ces diphtongues des parlers de l'albanais, ensuite on s'attache à expliquer les causes phonétiques des développements différents qu'ils ont pris dans ces parlers, approximativement à partir du temps quand l'uo fut branchée en ua/ue, et jusqu'à nos jours.

On a laissé de côté la diphtongue je /ie/ des verbes du type vjel, nxjerr, pjek ainsi que de plusieurs autres mots, comme: vjen (lat. venio), mjek (lat. medicus), Shtjefen (lat. Stephanus), etc., ou elle a été isolée de l'ie des mots diell, miell, ziej etc., car dans les premiers cas l'ie dérive d'un e, et, selon toute vraisemblance, est plus ancien que l'ie dans diell, etc. La distinction que nous faisons entre l'ie des mots vjel etc. et l'ie des mots diell, etc. est appuyée aussi par le fait que la première diphtongue est restée figée comme une diphtongue ascendante brève presque partout, et que, en général, son évolution n'a pas eu lieu conjointement avec les autres diphtongues ua/ue, ie, ye.

Quel est l'état actuel des diphtongues ua/ue, ie, ye dans les parlers de l'albanais? Reste à préciser où sont-elles prononcées comme diphtongues, où comme groupes de voyelles, et où sont-elles monophthonguées?

Considéré dans l'ensemble, on peut constater que ces trois diphtongues ont enregistré plus ou moins dans un parler la même allure durant leur évolution.

Comme groupes de voyelles dans toute position, elles se trouvent actuellement dans les parlers de l'extrême nord du dialecte guègue (dans les régions en-delà du cours du Drin, notamment dans les parlers intérieures des Malessies), dans les parlers de l'extrême sud du dialecte tosque (dans les zones au midi du cours de la Viose), dans la Dangëllie, la Shqerie, à Leskovik, même à Opar et Gore, ainsi que dans les parlers des installations albanaises à l'étranger. Des groupes de voyelles il y a dans la seule syllabe finale ouverte des parlers guègues entre les cours du Drin et du Mati, des parlers transitoires et la plupart des parlers tosques entre les cours de la Viose et du Shkumbin.

Les diphtongues sont monophthonguées partout et dans toute position dans le dialecte guègue méridional (entre les cours du Mati et du Shkumbin) et presque partout dans les parlers occidentaux et orientaux de l'extrémité septentrionale du guègue, de même que dans le parler des Albanais d'Ukraine, celui des Albanais de Monte Cîlfone et chez les au-

tres Albanais d'Italie. Dans le corps du mot (c'est-à-dire non point en syllabe finale ouverte) les diphtongues se trouvent monophthonguées généralement dans la zone entre le Drin et le Mati et dans les parlers transitaires.

Comme diphtongues, prononcées actuellement ascendantes et brèves se trouvent dans les parlers tosques entre la Viosë et le Shkumbin. Dans la plupart de ces parlers il y a diphtongue dans la seule syllabe se trouvant dans le corps du mot, tandis qu'à Devoll, dans le Skrapar du Sud, à Dishnice et Tepelene il y a diphtongue aussi en syllabe ouverte finale.

Nous croyons que les diphtongues se sont décomposées dans les parlers où elles n'ont pas été abrégées là où elles ont continué à être prononcées longues. Cela du fait que le processus de décomposition des diphtongues a eu lieu notamment dans le guègue et le tosque méridional, où ont été parfaitement gardées jusqu'à nos jours les voyelles longues, tant les primaires, que celles secondaires formées en raison de la position dans le mot ou en raison des modifications phonétiques intervenues dans les mots. Le processus de monophthongaison peut intervenir dans une diphtongue descendante ou dans un groupe de voyelles. Quoique Gj. Pekmezi n'ait pas fait, dans sa grammaire, une distinction entre les diphtongues et les groupes de voyelles, on entrevoit, néanmoins, que la monophthongaison a eu lieu dans une diphtongue descendante. On doit dire pourtant qu'E. Çabëj et A. Dodi sont plus exacts quand ils conjecturent que le processus de monophthongaison a eu lieu dans les groupes de voyelles. Mais, nous ajouterions que, compte tenu que ce processus a eu lieu dans un groupe de voyelles, alors il serait plus juste d'affirmer que, dans cette occasion, on a affaire à une contraction de voyelles. Le fait que les diphtongues sont régulièrement monophthonguées dans le seul corps du mot porte à opiner que la monophthongaison ait eu lieu pour la première fois dans le corps du mot. Les conditions phonétique qui ont donné jour à ce phénomène ne sont pas dues à la seule longueur des diphtongues, du fait que ces conditions ont existé aussi pour les parlers marginaux du guègue et du tosque, où les diphtongues, en raison de la longueur, se sont décomposées et sont restées des groupes de voyelles. Nous croyons qu'à cette occasion, en même temps que la longueur, dans les syllabes se trouvant dans le corps du mot ait influé aussi l'intensité relativement plus grande qu'à l'accent dynamique du mot en général dans le guègue et notamment dans le guègue méridional, où l'on a monophthongaison, dans toutes les positions et où sont intervenues de même d'autres nombreuses réductions qui parfois ont entraîné la disparition de sons ou de syllabes.

Les diphtongues qui continuent à exister encore dans le seul tosque septentrional sont prononcées actuellement brèves et ascendantes: buall-i, fyell-i, diell-i (dans certains parlers, comme nous venons de le faire remarquer, il y en a aussi en syllabe finale ouverte: thua, u thye, bie). Dans cette zone, comme on sait, n'ont pas été conservées les voyelles longues, et, par conséquent, aussi les diphtongues longues. Ainsi, commençant initialement en syllabes fermées, les diphtongues ont été prononcées brèves et ont été conservées comme les anciennes diphtongues *je /ie/* dans les cas comme *vjel, pjek, Pjetër, vjet, vjen*, etc. Après avoir eu lieu en syllabes fermées, ce processus s'est élargi aussi sur les diphtongues en syllabe ouverte dans le corps du mot, ce qui doit avoir lieu par analogie ou bien parce qu'antérieurement aussi les diphtongues n'étaient pas prononcées longues dans cette position, tandis qu'en syllabe

finale ouverte elles se sont décomposées dans la plupart des parlers, du fait que dans une telle position elles ne pouvaient pas être abrégées.

Sans ignorer aussi le facteur social, qui a concouru dans une certaine mesure pour la diffusion géographique des résultats des processus intervenus, on voit de toute évidence que la décomposition des diphtongues a été conditionnée par la longueur, l'intensité de l'accent et la position occupée à l'intérieur du mot, donc il s'agit d'un changement phonétique dans une position donnée, intervenue d'après des règles inégales sur des régions dialectales différentes.

La diphtongaison n'agit plus actuellement. Que ce phénomène n'est plus agissant, cela est parfaitement montré par les faits suivants: l'extension des diphtongues au moyen de l'analogie aussi dans ces positions où les conditions phonétiques ne le justifient pas: *mbuallëm*, *mbuallët*, *lyeva*, etc., et l'unification en *o* des noms du type *lakruar* au déterminé et à l'indéterminé: *lakror-i*, *qershori*, *krahror-i*, etc. (même, cela a commencé à paraître aussi des noms du type *truall*, *shuall*: *troll-i* *sholl-i*). La fusion en *o* dans *lakror-i* etc. a lieu parce que la diphtongaison n'agit plus sur les nombreux noms formés actuellement à l'aide du suffixe *-or* (*blegëtor*, *epror*, *rreshtor*), ainsi que dans les emprunts se terminant en *-or*, *-oll*, *-on* (*motor*, *tornitor*, *futboll*, *ballkon*).

En raison de l'influence mutuelle des parlers populaires, ont observé comme tendance générale aujourd'hui l'extension des groupes de voyelles au dialectes méridional et l'extension de la monophthongaison au dialecte septentrional. Dans le même temps, aussi la langue commune albanaise, notamment la langue littéraire, influe en ce sens au moyen de l'école, de la radio et de la presse, qui connaissent une grande extension dans notre pays. C'est sous l'influence de la langue littéraire que commencent à être répandus partout les groupes de voyelles. Cela indique que dans les modifications qui interviennent actuellement dans les diphtongues une large part a le facteur social.